

NJOFTIM PËR KONTRATË

 PUNË FURNIZIM SHËRBIME

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: **08.06.2026**

Nr i Prokurimit	623-26-4363-2-1-1
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË		
Adresa Postare: XHELAL HAJDA TONI		
Qyteti: RAHOVEC	Kodi postar: 21000	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Astrit Mullabazi		Telefoni: +38 20045316
Email: prokurimi.rahovec@gmail.com prokurimi.rahovec@rks-gov.net		Faksi:
Adresa e Internetit (nëse aplikohet): https://rahovec.rks-gov.net/		

Po



Jo



Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po



Jo



Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:

Ofrimi i shërbimeve të sigurimit fizik të objekteve të Komunës së Rahovecit

II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit

(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

<input type="checkbox"/> Punë	<input type="checkbox"/> Furnizime	<input checked="" type="checkbox"/> Shërbime
<input type="checkbox"/> Ekzekutim <input type="checkbox"/> Plani dhe ekzekutimi <input type="checkbox"/> Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	<input type="checkbox"/> Blerja <input type="checkbox"/> Qira financiare (lizing) <input type="checkbox"/> Qira <input type="checkbox"/> Blerje me këste <input type="checkbox"/> Një kombinim i këtyre	

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit

Në objekte të Komunës së Rahovecit

II.1.3) Njoftimi përfshinë

Krijimin e kontratës publike kornizë



II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë (nëse aplikohet):

Kontrate publike kornizë me një operator



Kontrate publike kornizë me disa operator



Ekzekutimi i kontratës:

Thirrje/Porosi



Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë



Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj 24

II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës

Ofrimi i shërbimeve të sigurimit fizik të objekteve të Komunës së Rahovecit

II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):

66311000-3

II.1.7) Variantet pranohen

Po Jo

II.1.8) Ndarja në Pjesë

Po Jo

Nëse po, tenderët mund të dorëzohen për (shënoni vetëm një kuti)

vetëm një pjesë Të gjitha pjesët

II.1.9) Informacione lidhur me pjesët (nëse aplikohen)

Nr. i pjesës	Emërtimi i grupit	Përshkrimi i shkurtër

Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:

II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 155,000.00

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

**Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)
Sipas përshkrimit të çmimeve dhe Specifikimet teknike të detyrueshme**

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj apo ditë (nga dhënia e kontratës)
apo
Fillimi
Përfundimi

NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit

Po Jo

Nëse po, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose 10 % e vlerës së kontratës % e vlerës së kontratës

III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t'u jepet kontrata (nëse aplikohet):

Në bazë të nenit 26.15, të ndryshim plotësisht të Rregullores Nr. 001 2022 për Prokurimin Publik, Operatorët Ekonomik që marrin pjesë si grup, së bashku me ofertën e tyre duhet të ofrojnë një Marrëveshje (deklaratën) për themelimin e grupit, në të cilën anëtarët e grupit do t'i përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë, si dhe të gjitha veprimet procedurale që duhet t'i kryej lideri i grupit në

emër të grupit. Plotësimi i Marrëveshjes (deklaratës) për themelimin e grupit, i vendosur në Aneksin 7 Deklarata për themelimin te grupit, është obligative për Operatorët Ekonomik që marrin pjesë si grup.

III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës

Po Jo

Nëse po, përshkrimi i kushteve të veçanta

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga <http://krpp.rks-gov.net>

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1 Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042, Plotësimi I Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit
Dëshmia 2 Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit.

Kërkohej kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Dëshmia 3 Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se
a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale; dhe
b. Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore.

Për piken (a) dhe (b) Kërkohej origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Dështimi i Operatorit Ekonomik të propozuar për shpërblim me kontrate në sjelljen e dokumenteve te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën e tij ta refuzoj, te konfiskoje sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është listuar ne vendin e dyte e kështu me radhë. **SHËNIM ME RËNDESI (OBLIGATIVE)** a. Kompanitë e huaja pjesëmarrëse në proces duhet të regjistrohen

	<p>dhe pajisen me licencën sipas Ligjit në Fuqi për Shërbimet Private të Sigurisë të Republikës së Kosovës, për të aplikuar në këtë procedurë tenderimi. b. Paga minimale neto bazë për punëtor të angazhuar në këtë kontratë duhet të jetë në shumë prej 456.50€. Operatori Ekonomik është i obliguar që të respektoj çdo vendim tjetër në lidhje me pagat minimale që mund të mirret në të ardhmen dhe gjatë kohës së ekzekutimit të kësaj kontrate. AK nëse paga minimale do të tejkalon vlerën minimale të caktuar atëherë do të ia kompenzoj OE-së në bazë të ligjeve në fuqi!</p>
<p>III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p>
<p>Kërkesa 1 Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit</p>	<p>Dëshmia 1 Certifikatën e regjistrimit të Biznesit – se bashku me informatat për biznesin, të lëshuar nga Autoritetet e Regjistrimit të Biznesit – Kopje</p>
<p>Kërkesa 2 Regjistrimi i TVSH – së</p>	<p>Dëshmia 2 Certifikatën e TVSH – Kopje</p>
<p>Kërkesa 3 Licenca për shërbimet themelore të sigurisë konform Ligjit për Shërbimet Private të Sigurisë</p>	<p>Dëshmia 3 Kopje e Licencës e lëshuar nga organi kompetent, valide. Kompanitë e huaja pjesëmarrëse në këtë proces duhet të regjistrohen dhe pajisen me licencë sipas Ligjit në Fuqi për Shërbimet Private të Sigurisë të Republikës së Kosovës për të aplikuar në këtë procedurë, pa marr parasysh nëse aplikon individualisht apo si anëtarë i ndonjë grupi të operatorëve ekonomik;</p>
<p>Kërkesa 4 Autorizimi individual për frekuencat për sistem radio komunikimi, lëshuar nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP)</p>	<p>Dëshmia 4 Kopje e Autorizimit individual për frekuenca të lëshuar në emër të kompanisë nga organi kompetent, valide;</p>
<p>Kërkesa 5 Leje e punës e lëshuar nga Kuvendi Komunal nga vendi ku operon operatori ekonomik</p>	<p>Dëshmia 5 Kopje e Lejes së punës apo vërtetim në rast mungese të lejeve nga komuna ku vepron, valide;</p>
<p>III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p>
<p>Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit (2023, 2024, 2025), në vlerë jo më pak se 310,000.00 Euro; Në rast konkursiumi lideri duhet të ketë të paktën 60 % të vlerës së qarkullimit;</p>	<p>Dëshmia 1 Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK ose Raport nga Banka e vulosur dhe e nënshkruar origjinale nga ndonjë banke e licencuar në Kosovë;</p>
<p>III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p>
<p>Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka realizuar me sukses kontrata të natyrës së njëjte, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 232,500.00 Euro; Në rast konkursiumi lideri duhet të ketë të paktën 60 % të vlerës;</p>	<p>Dëshmia 1 Lista e shërbimeve të realizuara, duke plotësuar ANEKSIN 8 të Dosjes së Tenderit, në lëmin e shërbimeve të njëjte të realizuar në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, DHE kësaj liste duhet ti bashkëngjiten si dëshmi (i) kur shërbimi është bërë për një Autoritet</p>

	<p>Publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata raporti i përkohshëm i pranimit) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë, të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar, (ii) kur shërbimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë me dëshmi të pagesës nga banka;</p>
<p>Kërkesa 2 Operatori ekonomik duhet të ketë të gjitha uniformat dhe pajisjet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të sigurimit themelor si miniveglat, shufra, pranga, fotoaparati, bateri ndriqese, breza, radio lidhje mobile dhe fiks, detektor metali, pasqyre për kontrollimin e automjeteve, jelek takik dhe mbrojtës, uniformat sipas specifikacionit teknik në Aneks 1</p>	<p>Dëshmia 2 Të dëshmohet me licencë, raport, foto dhe vendime (kopje). SHËNIM Në lidhje me këtë pikë, ky kriter mbulohet me Licencën për Shërbime Themelore të Sigurisë, konform Ligjit, duke ia bashkangjitur edhe si dëshmi një raport mbi uniformat dhe pajisjet teknike me fotografi dhe njoftimin e MPB të lëshuar për pajisje. Operatori ekonomik po ashtu duhet të dëshmojë se ka pajisje dhe uniforma të mjaftueshme në dispozicion përmes një deklarate duke ia bashkangjitur edhe faturat e blerjeve dhe transaksionet e bankës. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë që në çdo qastë të vie në zyrë të kompanive për verifikim. Si dhe ruan të drejtën e verifikimit dhe të kontrollit të çdo lloji informacioni të dhënë nga OE për këtë proces të prokurimit;</p>
<p>Kërkesa 3 a) Marrëveshje ose Memorandum bashkëpunimi me një “Qendër Trajnimi” për kryerjen e trajnimeve të rojeve të sigurimit në fushën themelore dhe të specializuar sipas Ligjit për Shërbimet Private të Sigurisë (valide), duke ia bashkangjitur dokumentet e instruktorëve të angazhuar për shërbimet themelore të sigurimit dhe shërbimeve të specializuara; b) Certifikata e Qendrës së Kontrollit sipas Ligjit për Shërbimet Private të Sigurisë; c) Licenca për Shërbimet e Vëzhgimit Elektronik të Pronës sipas Ligjit për Shërbimet Private të Sigurisë (valide); d) Licenca për Shërbimet e Tubimeve Publike sipas Ligjit për Shërbimet Private të Sigurisë</p>	<p>Dëshmia 3 (a) Të dëshmohet me marrëveshje dhe licencat e qendrës së institucionit të trajnimit (kopje) (valide), certifikatat e MPB, CV dhe diplomatat e shkollimit për instruktorët e shërbimit themelor dhe shërbimeve të specializuara (kopje), (b) të dëshmohet me certifikatë (kopje); (c) të dëshmohet me licencë nga MPB (valide) (kopje); (d) të dëshmohet me licencë nga MPB (valide) (kopje);</p>
<p>Kërkesa 4 Operator ekonomik duhet të posedojë min. (5) operator të sigurisë të certifikuar për monitorimin e sistemeve të sigurisë. SQARIM Operator nënkupton stafi i cili angazhohet nga operatori ekonomik i cili staf është i certifikuar për monitorimin dhe vëzhgimin e sistemeve të sigurisë (valide);</p>	<p>Dëshmia 4 Të dëshmohet me listë të stafit dhe me certifikatë të operatorëve të sigurisë nga MPB (kopje);</p>
<p>Kërkesa 5 Operatori ekonomik duhet të posedojë min. (5) punëtor të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe mbrojtje nga zjarri në përputhshmëri me Ligjin Nr.04 L-161 sipas organogramit të kompanisë;</p>	<p>Dëshmia 5 Për të njëjtit të dëshmohet me listë me kopje të certifikatave dhe organogrami i kompanisë (valide) (kopje);</p>
<p>Kërkesa 6 Operatori ekonomik duhet të ketë raportin e vlerësimit të riskut të kompanisë lëshuar nga; a) organet (institucioni) përgjegjës</p>	<p>Dëshmia 6 Të dëshmohet; a), b) me dokument dhe raport (kopje) (valide), licenca e kompanisë së licencuar (kopje) (valide);</p>

<p>ose, b) nga ndonjë kompani e licencuar për vlerësim të riskut të bizneseve;</p> <p>Kërkesa 7 a) Operatori ekonomik duhet të caktoj një menaxher të projektit me vendim i cili ka përvojë pune min. 5 vite, dhe që është i certifikuar nga MPB si menaxher i sigurimit zyrtar në detyrë për shërbimet themelore dhe për shërbimet të specializuara vëzhgim elektronik të pronës e tpg konform Ligjit për Shërbimet Private të Sigurisë (valide), i njëjti duhet të jetë i certifikuar edhe për ndihmën e parë nga Kryqi i Kuq, dhe për menaxhim projektsh sigurie. b) Operatori ekonomik duhet të angazhoj personelin profesional për shkak të volumit të madh të objekteve dhe numrit të madh të punëtorëve të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme; a. dy ndihmës menaxher me vendim të njëjtët duhet të jenë të certifikuar nga MPB për shërbimet themelore të sigurisë të cilët kanë përvojë pune min. 3 vite; dhe b. një menaxher të certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare për menaxhimin e riskut me certifikatë i cili ka përvojë pune min. 3 vite pas certifikimit, i cili do të monitoroj kualitetin e shërbimeve që ofrohen dhe të shqyrtoj dështimet apo mangësitë në ofrimin e këtyre shërbimeve të sigurisë;</p>	<p>Dëshmia 7 (a) Të dëshmohet në CV; përvoja e punës; trust, referencë, diploma e shkollimit, certifikatat e MPB për shërbimet themelore të sigurisë (MShThS) dhe për shërbimet e specializuara (MOME-TPG), si dhe certifikata për ndihmën e parë (valide) (kopje), dhe certifikatën. (b) Për pikën a) të dëshmohet përvoja e punës me trust, CV, referencë, diploma e shkollimit, certifikatat e MPB për shërbimet themelore të sigurisë (MShThS) (kopje), për pikën b) të dëshmohet përvoja e punës me trust, CV, referencë, diploma e shkollimit, certifikata përkatëse;</p>
<p>Kërkesa 8 Operatori ekonomik duhet të posedoj më së paku (2) automjete patrulluese; kjo kërkesë bëhet për arsye sigurie si dhe në rast të intervenimeve urgjente në objektet e Komunës së Rahovecit, njëra prej veturave duhet të jetë më drita alarmuese (dritë sinjalizuese me ngjyrë të verdhë) shih Neni 201 të Ligjit Nr. 08 L-186 dhe Neni 6.1.7 të Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr.10 2017. OE mund të ofrojnë edhe marrëveshje me një kompani për shfrytëzimin e veturave (Rent a Car), kompania duhet të jetë e regjistruar si veprimtari për dhënien e veturave me qera pra rent a car;</p>	<p>Dëshmia 8 Të dëshmohet me listë, kopjet e librezave të regjistrimit të Automjeteve (me validitet regjistrim) me shënimin përkatës, dhe se Automjetet duhet të jenë të regjistruara në emrin e Operatorit Ekonomik, për veturën me sinjalizim dëshminë përkatëse, apo marrëveshja me kompaninë (Rent a Car) për periudhën sa do të zgjasë kontrata dhe kopjet e librezave valide në emër të Rent a Car si dhe dokumentet e biznesit me informata;</p>
<p>Kërkesa 9 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me këto certifikata ndërkombëtare konform Nenit 70 të LPP-së si a) Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë në lëmin e sigurimit fizik, me ISO Certifikatë 9001 (valide). b) Operatori duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë në lëmin e sigurimit fizik, ISO Certifikatë 45001 (valide). c) Operatori duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të sigurisë së informacionit në lëmin e sigurimit fizik, ISO Certifikatë 27001 (valide). d) Operatori duhet të bashkëngjis edhe certifikatën e akreditimit të kompanisë e cila ka lëshuar certifikatat në fjalë;</p>	<p>Dëshmia 9 Për pikat (a), (b), (c) dhe (d) Të dëshmohet me certifikatat përkatëse për secilën (kopje). SHËNIM ME RËNDËSI Certifikatat duhet të posedojnë likun e faqes për verifikim online të validitetit të certifikatave dhe të jenë të regjistruara në International Accreditation Forum (IAF). Të gjitha certifikatat të cilat nuk verifikohen në sistem ueb do të trajtohet inicimi i procedurës konform Nenit 99.2 të LPP për diskualifikim. Në rast të aplikimit si grup i OE-ve konform nenit 26.6 të Rregullores Nr. 001 2022, në lidhje me certifikatat e cilësisë duhet të sillen nga secili anëtar i grupit së bashku me tenderin e tyre. Kurse për pikën (d) duhet të bashkëngjitet certifikata e akreditimit të kompanisë e cila ka lëshuar certifikatat në fjalë;</p>
<p>Kërkesa 10 a) Deklaratë me shkrim nga</p>	<p>Dëshmia 10 Për pikat (a) Të dëshmojen me</p>

<p>operatori ekonomik se do t'i përmbahet në përgjithësi specifikimeve teknike të detyrueshme të paraqitura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit dhe të bashkangjet gjitha dëshmitë e kërkuara. b) Operatori ekonomik duhet të prezantojë listën e stafit me të cilin planifikon të mbulojë kërkesat e dala nga kjo dosje e tenderit dhe nga paramasat. c) Operatori ekonomik duhet të deklarohet se pagat e punëtorëve do të paguaj për muajin paraprak, më së largu deri me datë 10 të muajit në vijim, pa marr parasysh pagesën e bërë nga AK. d) Operatori ekonomik duhet të ofroj analizën financiare të ofertës duke përfshirë kompensimet si pagat e punëtorëve në vlerën neto 456.50 €, pagesat e kontributeve pensionale, tatimin e mbajtur në burim sipas shkallës tatimore, duke kalkuluar shtesë edhe pagesën e shtesave konform Ligjit të Punës si orët e natës, festave, vikendit, pushimit vjetor, plus shpenzimet operative materialet dhe profitin e kompanisë, gjatë kalkulimit të rrespektohet edhe norma prej 176 orë pune sipas UA Nr.09 2017 MPMS. AK nëse paga minimale do të tejkalon vlerën minimale të caktuar atëherë do të ia kompenzoj OE-së në bazë të ligjeve në fuqi!</p>	<p>dokumente dhe deklaratë nga operatori ekonomik të cekurat (original), (b) Lista e të punësuarëve, përshkrimi i shkurtër i vendit të punës. (c) Deklarata origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga OE në lidhje me pagesën e pagave. (d) Analiza financiare duhet të ketë kujdes dhe të paraqitet me të gjitha elementet e kërkuara konform ligjeve në fuqi, dhe duhet të përfshijë saktë vlerat;</p>
<p>Kërkesa 11 Operatori ekonomik duhet të posedoj min. (5) punëtor të certifikuar ose edhe të licencuar për përdorimin e aparateve kundër zjarrit (zjarrëfikjes). Kjo kërkesë vendoset për shkak të ndonjë ndodhie që mund të paraqitet në të ardhmen e që punëtorët e sigurimit duhet të jenë të aftë në fikjen dhe parandalimin e zjarrit derisa arrijnë organet kompetente;</p>	<p>Dëshmia 11 Të dëshmohet me listë dhe certifikatat e punëtorëve për përdorimin e aparateve kundër zjarrit (zjarrëfikjes) të lëshuara nga organi kompetent apo kompanitë të cilat janë të licencuara për trajnimin dhe lëshimin e certifikatave, po ashtu të bashkangjitet edhe autorizimi apo dokumenti i lëshuar nga organi kompetent për kompaninë e cila ka të drejtën e lëshimit të certifikatave të tilla dhe mbajtjeve të trajnimit;</p>

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

<p>Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/></p> <p>III.3.1) Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar</p> <p><i>Nëse po</i>, referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse</p>
<p>III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve</p> <p>Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/></p>

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

<p>IV.1.1) Lloji i procedurës</p>
<p><input checked="" type="checkbox"/> E hapur</p>
<p><input type="checkbox"/> E kufizuar</p>

Konkurruese me negociata

Kuotim i Çmimit

IV.1.2) Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim (*procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata*)

Në bazë të aplikacioneve të pranuar, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave (*procedurë konkurruese me negociata*)

Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme

Po Jo

në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar

Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata

Po Jo

IV.1.4 Numri minimal i kandidateve të cilët do të ftohen që të dorëzojnë Tenderët fillestar është:

IV.1.5. Informata në lidhje me ankandin elektronik

Do të përdoret ankandi elektronik: Po Jo

Informata shtese në lidhje me ankandin elektronik:

IV.2) KRITERET E DHËNIES

Çmimi më i ulët

ose

Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë

Po Jo

Nëse po,

Njoftim paraprak: i

Publikime tjera (*nëse aplikohen*):

i

i
<p>Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/></p> <p>Dokumentet me pages</p> <p><i>Nëse po</i>, çmimi EUR</p> <p>Kushtet dhe metoda e pagesës:</p>
<p>IV.3.2) Afati i fundit për pranimit të tenderëve / aplikacioneve:</p> <p><i>data</i> 24.06.2026 <i>koha</i> 14:00:00 <i>vendi</i> https e-prokurimi.rks-gov.net</p>
<p>IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve / aplikacioneve është shkurtuar:</p> <p><input checked="" type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo</p> <p><i>Nëse po</i>, jep arsyetim Bazuar në shkresën e njësisë kërkuese arsyetim për shkurtim afati kohore është i domosdoshëm për shkak të skadimit të kontratës paraprake dhe duke marrë parasysh nevojës urgjente me qëllim të shmangies së çdo rreziku operacional dhe sigurimit të vazhdimësisë së shërbimeve, dhe për rrjedhojë, ekziston rreziku pa mbulim kontraktual, duke lënë të pambrojtura objektet dhe asetet që aktualisht mbulohe me shërbime të sigurimit fizik, kërkojmë iniciimin e kësaj procedure në afatin kohore të shkurtuar</p>
<p>IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit:</p> <p>Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/></p> <p><i>Nëse po</i>, vlera e sigurisë së tenderit 4,000.00 Euro</p> <p>Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë 120 apo muajt</p>
<p>IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:</p> <p>Deri më: data: ditët 90 apo muajt</p>
<p>IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:</p> <p><i>data</i> 24.06.2026 <i>koha</i> 14:00:00 <i>vendi</i> https e-prokurimi.rks-gov.net</p>

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ne adresën e specifikuar ne Nenin I të këtij Njoftimi për kontratë.

V.2) INFORMACIONET SHITESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.

Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita në punishte etj)

- Autoriteti Kontraktues Komune Rahovecit ju informon se sipas vendimit të KRPP – se Nr. 91 2018 dhe RRUOP, që tenderi duhet të dorëzohet vetëm në mënyrë elektronike (ne asnjë mënyrë ne versionin tjetër). Ky është kusht i tenderit i cili duhet respektuar për të mundësuar pranimitin e ofertës si të “përgjegjshme” administrativisht.**